

## EDHE NJË HERË PËR GJUHËN SHQIPE

Problemi i vlerësimit me seriozitet të gjuhës nuk është një problem i ri, por as i vjetër, sepse për gjuhën kombëtare veçanërisht për ruajtjen, zhvillimin dhe pasurimin e saj, janë të interesuara e shqetësohen të gjithë shtetasit e popullsisë në secilin vend. Është e natyrshme se ky shqetësim është i pranishëm edhe te gjuhëtarët tanë, profesorët e kësaj lënde, mësuesit që e japin këtë lëndë me pasion, te shkrimtarët që e pasurojnë dhe nga një pjesë e mediave. Gjuha shqipe nuk u përket vetëm atyre. Ajo është pasuri e gjithë kombit dhe, çdo njeri, që e quan veten shqiptar e ka detyrim moral e atdhetar që të kujdeset për të, që herë pas here të mendojë për të, që, kur është e mundur të ndihmojë zhvillimin e saj në të gjitha format e mënyrat, në dobi të Atdheut. Sa e sa herë është shkruar për bukurinë e gjuhës sonë, sa vargje e krijime të tjera i kushtohen asaj, sa atdhetare kanë luftuar për të! Kujtoni vargjet e bukura e emocionuese edhe në ditët tona, si ato të Naimit, Fishtës, Mjedës e qindra të tjerëve. Ajo është ndër shenjat kryesore që na bëjnë të ndihemi mire, që edhe të tjerët ta njohin e ta dallojnë identitetin tonë kombëtar. Kjo lloj ndienjë nuk barazohet kurrësi me nacionalizmin e sëmurë dhe as ka të bëjë me atë lloj krenari të shtirur kombëtare, por është shenjë e vitalitetit dhe jetëgjatësisë së vlerave tona të vërteta që mbart gjithë populli. Me një fjalë, të kujdesesh për gjuhën e vatanit tënd, nuk do të thotë në asnjë rast se nisemi nga ndienja shoveniste. Përkundrazi, këto janë ndienja të kulluara atdhedashurie, ashtu sikurse ndodh në shumicën e popujve të botës. A mund t'i akuzojmë ata për shovenizëm, kur ndodh, që edhe kur njohin një gjuhë tjetër të huaj që e di edhe bashkëbiseduesi nga një shtet tjetër, ata përdorin gjuhën e vendit të vet? Me atë gjuhë ai është në gjendjen më të mirë që të komunikojë me folësin. Aq krenari sa kanë psh francezët për gjuhën e tyre, gjermanët e qindra të tjerë, po aq krenari kemi ne për shqipen tonë, sepse është gjuha jonë, e të parëve tanë, gjuhë që sikur buron

nga malet e fushat tona, gjuha e një populli që ka ditur ta mbrojë dhe ta zhvillojë atë, i sigurtë se është një nga gjuhët më të vjetra të gadishullit tonë, sikurse e kanë pohuar e vërtetuar me kohë edhe studjuesit e huaj, nga albanologë me emër në Europë.

Asnjë prej nesh nuk është kundër ndërndikimit gjuhësor, sepse në ditët tona ky fenomen është i pashmangshëm. Gjithashtu, në kohën tonë nje vend nderi zë anglishtja, ku gjejmë informacionet më të plota, ku gjejmë përfundime të vërtetuara shkencore, ku gjejmë të rejtat që përhapen në botë e do të ndihmojnë në zhvillimin e botës dhe në përmirësimin e jetës. Të gjitha këto kanë bërë që ky ndikim, me të drejtë është studjuar nga linguistët e sociologët jo vetëm si një dukuri gjuhësore, por së pari sociologjike, kulturore, psikologjike etj.. Gjithnjë, përdorimi i fjalës së huaj në vend të fjalës shqipe, ka pasur edhe një shkak shoqëror, kulturor ose botëkuptimor. Era e re e demokracisë, shndërrimet e thella në jetën e vendit e kanë ofuar mundësinë e përfshirjes në kontakte të vazhdueshme me vendet e tjera, si partnerë të besueshëm. Gjuha është një mjet që ndihmon për të fituar kulturën kombëtare. Ne jemi shqiptarë sepse flasim shqip. Përdorimi i saj me mjeshtri është tregues i njeriut të kulturuar Megjithëatë, midis nesh ka të tjerë, që me një përulësi të mjerë, mendojnë se gjuha shqipe është e varfër dhe nuk mund të paraqesë gjithë formimin e mundshëm kulturor. Po të vëresh të thënat e këtyre njerëzve, fjalori që ata përdorin, përmbledh një numër të caktuar fjalësh, që, rrallë, i kalon 4500. Kjo do të thotë se gjuha shqipe i nxë me tepricë të pabeseushme dijet e tyre të “mëdha” dhe mund t’i transmetojë besnikërisht ato. Dikush mburret se di gjuhë të huaja dhe i duket se duke përdorur fjalë prej atyre gjuhëve tregohet “i ditur”, “modern”, “i bën përshtypje shefit”, “është trendy” duke shfaqur hapur, për fat të keq, paaftësinë e tij në mosnjohjen e pasurisë së pallogaritshme të shqipes. Janë ata që kanë në majë të gjuhës fjalë të tilla si rural në vend të: fshatare, e fshatit apo bipartizan në vend të: shumëpalëshe, dypalëshe; biznesmenë/ biznes në vend të: tregtarë, tregti; stanjacion në vend të: amulli, pezull. etj. .

Dihet se gjuha është ndër mjetet kryesore., me të cilën njeriu shpreh gjendjen e tij shpirtërore dhe, sipas rastit, u bënë të ditur të tjerëve mendimet, ndienjat dhe përjetimet e veta. Kështu, falë funksioneve të saj të veçanta, gjuha shërben si nje mjet nxitës

për zhvillimin e shoqërisë, si mjet që u jep njerëzve mundësinë të organizojnë punën e përbashkët në të gjitha fushat e jetës shoqërore. në veprimtari njerëzore bashkëpunimi, ashtu edhe në jetën vetijake. Në anë tjetër dihet roli i pazëvendësueshëm i gjuhës së shkruar, duke mbetur mjeti më masiv i përhapjes së informacionit. Ajo përfaqëson një komunikim të rehatshëm, për të marrë e dhënë atë çka e gjykon se të nevojitet apo të vlen në përmirësimin e punës e jetës tëndë. Kështu, gjuhën e vëmë në përdorim për të dhënë një përmbajtje të caktuar, me një qëllim të qartë, për një auditor, me një rast dhe një kohë të caktuar, duke shprehur një qëndrim të vërtetë.

Nuk është pavend të risjellim në kujtesë kontributin e madh të njerëzve të letrave e të studimeve albanologjike për ruajtjen dhe mbrojtjen e pastërtisë së gjuhës shqipe. Po të gërmosh në jetën e tyre ose po të lexosh monografitë e shumta të shkruara për to, vëren me kënaqësi, se problemi i ruajtjes së pastërtisë së gjuhës sonë kombëtare ka qenë gjithnjë në qëndër të vëmendjes së tyre, veçanërisht për të mos lejur futjen e fjalëve të huaja në vend të atyre shqipe dhe krijimin e neologjizmave të reja. Këtu mund të rradhisim shumë emra të shquar, por këtë nuk po e bëjmë, sepse lista do të ishte shumë e gjatë. Në këtë listë bëjnë pjesë gjuhëtarë, poet e shkrimtarë shqiptarë. Të marrim vetëm Naimin. Poeti ynë kombëtar krijoi fjalë të reja që kanë hyrë në fondin tonë aktiv, si fletore, mësonjëtoje, mësuës, dituri, dheshkronjë (për gjeografi) etj. Veçse nuk ka shkrimtarë, poet etj që ka shkruar të pakën disa vepra që të mos kenë sjellë bashkë me to edhe një tog fjalësh të reja ose u ka fshirë pluhurin e kohës fjalëve të vjetra shqipe, me një kuptim e tingëllim të pastër.

Është thënë me të drejtë se në Kuvendin e Shqipërisë, në seancat e zakonshme, si rregull, diskutimet fillojnë, mirë e bukur, kështu: E nderuara zonja kryetare (ose kryetar i seancës), të nderuar deputetë (ose kolegë). Kjo është fjalori më i spikatur i etikës së saktë parlamentare. Deri këtu është fare në rregull. Mirëpo kur, ndonjë fillon të flasë, në fjalorin e tij përzihen e sikur përpiqen kokë më kokë, fjalë të padëgjua më parë, marrë nga fjalorë të gjuhëve të huaja. Në këtë mënyrë, ndodh e kundërta e qëllimit të folësit (mbase do t'i bwj përshtypje shefit të tij e mos më keq nëse mendon se po të flasë me fjalë të mëdha, që të thonë të tjerët sa i mençur qenka ky, etj), Ndërkohë, në këto folës, nuk shfaqet "erudicioni"

i madh i tij, por paraqitet mangësia e kulturës gjuhësore, që bart në vetvete edhe mungesën e të shprehurit thjeshtë e saktë. Kjo vjen se, pa u thelluar, i mveshin mendimit shqip edhe një rrobe të huaj, që përgjithësisht nuk është e strukturës gjuhësore të shqipes. E thënë hapur, kjo e folur tingëllon fallco.

Gjuha është e tillë që merr jetë e materializohet gjatë komunikimit të njerëzve: si me gojë, ashtu edhe me shkrim. Këtu dalin në pah edhe mangësitë e tepruar, ai lloj anashkalimi, ajo nëpërkëmbje e pajustikuar, që i bëhet asaj. Le të nisemi nga instancat më të larta, ku qendrojnë deputetët, pa numëruar vargun e gjatë të njerëzve të tjerë me poste. Nuk janë të rrallë ministrat e zv. e tyre, disa deputetë që përdorin një gjuhë të kuptueshme, të qartë dhe të pasur në fjalor e që ta ka ënda t'i dëgjosh. Me këta, populli që i ka zgjedhur, ndihet mirë, se atë që thotë ai, e kupton dhe e vlerëson punën dhe përkushtimin e tij për plotësimin e premtimeve. Në anë tjetër, ka jo pak vite që na bënë çudi gjuha e papunuar dhe fjalori i varfër për të folur shqip. Kjo ndodh edhe për arsyen se përdoren sa më s' bëhet fjalë të huaja. Kur i dëgjon të duket sikur ka një garë të heshtur: secili ose akcili të përdorë më shumë fjalë të tilla. Këtu nuk bëhet fjalë për ta qëruar (pastruar) atë nga fjalët e huaja, që gjithçka të tingëllojë shqip. Janë bërë me dhjetra deklarime dhe është shkruar jo pak për këtë shqetësim të sotëm, që, së pari duhet ta kenë njerëzit e zgjedhur nga populli, të cilën mendoj që e kanë jo vetëm detyrë morale ose ata që përpiqen të bëjnë rolin e analistëve, një pjesë e gazetarëve të ndërgjegjshëm të medias elektronike, ku dallohen ato të medias së shkruar.

Është i njohur ndikimi dhe roli i medias së shkruar, ashtu edhe i letërsisë, që edhe njerëz pa ndonjë formim të posaçëm gjuhësor, i kanë përdorur ato si model dhe, me intuitë, kanë mësuar ta shkruajnë mirë gjuhën shqipe. Ndërkohë, është e njohur ndihmesa e madhe që mund të jap media e shkruar dhe dobia e pazëvendësueshme e leximit të letërsisë artistike, për aftësimin gjuhësor. Të dish gjuhë të huaja është një dritare më tepër për të njohur botën, por kur nuk di të formulosh drejt mendimet e tua në fjali ose kur nuk njeh rregullat e drejtshkrimit, nuk është faji i gjuhës së huaj. Materialet e këtyre njerëzve bien menjëherë në sy edhe për mënyrën e gabuar të ndërtimit të tyre, paçka se nuk janë të rrallë ata i paraqesin sikur janë kontribute "origjinale".

Mediat janë më të dëgjuarat e më të shikuarat, të cilat janë krijuar si të tilla dhe lipset të përballen me publikun e gjerë. Nuk është e dobishme, kur mjafton të dëgjosh disa emisione ose të lexosh gazetatat dhe shpejt mund të formosh një listë, ku jo vetëm përdoren fjalë të huaja pa vend, por edhe pa kuptim, aq sa jam i bindur se edhe vetë folësit e tyre nuk dijnë se çfarë thonë. Kjo nuk është shenjë e përruljes para kulturës së të tjerëve. Jo, ajo shkon më tej. Kjo është shenjë e formimit të cunguar kulturor të tyre, si me gjuhën shqipe, si me gjuhën e huaja, pasi edhe gjuhët e huaja kanë shprehjet e tyre frazeologjike dhe sinonimet e veta. Cilësia më e rëndësishme është qartësia. Të jesh i qartë do të thotë, në radhë të parë, të jesh i kuptueshëm. Për këtë njerëzit synojnë që të shprehen thjeshtë, natyrshëm, rrjedhshëm, pra të shmangin mënyrat e ndërlikuara, të tërthorta, të vështira, me fjalë e shprehje të errëta, të panjohura ose të huaja.

Krahas shqetësimit të vërtetë që ekziston, në Shqipëri, ka disa media elektronik e të shkruara, që s'e vënë shumë ujin në zjarr për këtë problem. Kjo ndodh për faktin e thjeshtë e të njohur se gjuha shqipe po cungohet, duke përdorur edhe aty ku s'duhet fjalë të huaja, veçanërisht anglisht, frëngjisht e italisht, për të mos u ndalur pastaj edhe te... paidhaqet. Përdorimi i fjalëve të huaja shkon deri atje sa zëvendësohen edhe fjalët shqipe me të tilla, fjalë të cilat nuk janë të njohura dhe nuk kuptohen nga më shumë se 65 % e popullsisë në qytet dhe 95 % në fshat.

Pak vjet më parë, në Fakultetin e Historisë e Filologjisë, në departamentin e gjuhës shqipe kam qenë udhëheqës shkencor i disa studentëve të veçantë, që me paraqitjen e temës studimore mbronin diplomat e përfundimit të fakultetit. Më ka mbetur në mendje një vajzë nga Durrësi, e cila në temën e saj prekte edhe problemin e gabimeve dhe të përdorimit të fjalëve të huaja në shkrimet më të rëndësishme të botuara në shtyp. Ish studentja, sot, me siguri mesuese, u përqendrua në 5 gazetatat, që ajo i vlerësoi si kryesore, që botohen e dalin në Tiranë dhe lexoi e gjurmoi gabimet gjuhësore si dhe përdorimin e fjalëve të huaja. Më pas ajo i analizoi e bëri punën e saj. Ajo që duhet thënë është se nga materialet që shfletoi ajo kishin një përdorim të madh të fjalëve të huaja, në një kohë që gjuha jonë e ka fjalën përkatëse në shqip. E pata këshilluar që pas mbrojtjes, t'ia dërgonte secilës gazetë ato gabime dhe

fjalë të huaja që ato kishin përdorur në shkrimet e tyre për një periudhë të caktuar kohe, me qëllim që t'i mënjanonin. Nuk e di se ç'bëri studentja, pasi nuk e kam takuar, por edhe sot e gjithë ditet në gazeta gjejmë materiale që përfshijnë brenda shkrimeve që publikojnë shumë fjalë të huaja, jo si shenjë përulje para të tjerëve, por si mos njohje, zhvlerësimi e, pse jo, sigurisht "me qëllim jo të keq", që realisht s'është më pak veçse nëpërkëmbje e gjuhës amtare.

Fjalët e përdorura nga ish deputetë e ndonjë deputet i veçantë, ish ministra e zëvendësministra si dhe intervista rrugore, që, fatkeqësisht, jepen pa as më të voglën përkujdesje e që janë me tepri, nga fjalët më të përdorshmet janë edhe këto: të arrijmë në një konsensus për një kuorum..., ...për të revokuar atë që ke, ... tregojnë se ka një mungesë subrenizmi, ...dhe kjo lançohet nga media, ...kërkoj pak suspancë, ...në këtë takim të eurosongut, ... do të kërkoj një endicipim, ...pritet të involvojë etj.

Nuk është vendi për të folur për tekstin e reklamave, që në shumicën e tyre, kanë gabime në strukturën e ndërtimit të fjalisë. Por reklama të tilla si: prej shumë vitesh kompania jonë plotëson ekzigjencat e një publiku me tendenca kontemporane, janë në kundërshtim me arritjet, ritmet dhe zhvillimet e albanologjisë mbarëshqiptare.